

VULA KATRORE

Neni 8

Vula katërore e ndërmarrjes komunale ka formën e drejtkëndëshit në të cilën është shkruar firma dhe selia ndërmarrjes.

ЈАВНО КОМУНАЛНО ПРЕТПРИЈАТИЕ

NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE

С А Р А Ј – С А Р А Ј

Бр.- нр. _____

_____ 201 ____ год.-viti

Скопје - Shkup

Neni 9

Forma e përdorimit dhe ruajtja e vulës dhe vulës katrore të Ndërmarrjes regullohen me vendim të Drejtorit, sipas Ligjit.

V. AMBLEMI

Neni 10

Ndërmarrja ka amblemin e saj cili prezenton veprimtarin e punës.

VI. VEPRIMTARIJA E NDËRMARRJES

Neni 11

Ndërmarrja është subjekt juridik e cila kryen veprimtari me karakter publik në sferën e shërbimeve komunale.

Neni 12

Në punët juridike në marrëdhëniet me kompani të palës së tretë ndërmarrja vepron në emër të saj dhe për llogari të vet. Për detyrimet ndaj palëve të tretë të ndërmarrja në emër të saj dhe për llogari të vet, kompania përgjigjet me gjithë pronën.

Neni 13

Ndërmarrja Komunale në suaza të veprimtarisë së vetë i kryen këto detyra:

90.0 Largimi e mbeturinave dhe plehërave, aktivitete sanitare dhe tjera.

- Pastrimi i sipërfaqeve publike në vendbanime
- Largimi i deponive dhe përpunimi i mbeturinave
- Rregullimi dhe mirëmbatja e parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbruara dhe sipërfaqeve rekreative,
- Prodhimi dhe distribuim të ujit;

41.00 - mbledhja, ripastrimi dhe distribuimi i ujrave të papastër

60.21 - transport të udhëtarëve në komunikacionin tjetër tokësor;

74.84 - aktivitete tjera afariste, të papërmendura në vend tjetër

93.03 - shërbimi për varim dhe aktivitete tjera përcjellëse;

45.23 - rregullimi i rrugicave dhe rrugëve

93.05 - aktivitete tjera shërbyese të pa përmendur

* Përpunimi dhe dërgimi i ujrave teknologjike;

* Mirëmbatja e ndricimit publik;

* Dërgimi dhe lëshimi i ujrave atmosferike ;

* Mirëmbatja dhe shfrytëzimi i hapsirave publike për parkim;

* Mirëmbatja dhe shfrytëzimi i tregjeve me shumicë dhe pakicë;

* Mirëmbatja e orendime komunale;

* Mirëmbatja e rrjetit të ujësjellësit;

* Menjanimi dhe rruatja e automjeteve jorregullisht të parkuara;

* Eradikcioni i kafshëve endacake, zbukurimi i vendbanimeve;

* Mirëmbatja e nyjeve publike sanitare, dezinfektimi, deratizimi etj.

Neni 14

Ndërmarrja Komunale mund ta ndryshojë veprimtarinë me:

-zgjerimin e veprimtarisë,

- themelim të veprimtarive të reja,
- shuarjen e disa veprimtarive të caktuara,

Për të gjitha ndryshimet e lartpërmendura bjen vendim Këshilli Drejtues me pëlqim paraprak të themeluesit.

Neni 15

Ndërmarrja aktivitetin e interesit publik e kryen gjithmonë dhe pa ndërprerje, dhe puna e tij është publike dhe transparente, në përputhje me ligjin, këtë Statut dhe standardet financiare ndërkombëtare për sektorin publik.

Ndërmarrja është e detyruar të sigurojë transparencë në marrëdhëniet financiare në operacionet e veta materiale financiare sipas ligjit, këtë Statut dhe standardet financiare ndërkombëtare për sektorin publik.

VII. PËRFAQËSIMI DHE PARAQITJA

Neni 16

Në kuadër të kompetencave të saj, Ndërmarrjen e paraqet dhe e përfaqëson Drejtori i Ndërmarrjes. Drejtori i Ndërmarrjes, me anë të autorizimit me shkrim, mund të autorizojë një person tjetër që të përfaqëson kompaninë.

Përmbajtja dhe shtrirja e autoritetit të paragrafit të mësipërm do të përcaktohet nga Drejtori i Ndërmarrjes.

Neni 17

Organizimi i Ndërmarrjes më detajisht rregullohet me aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ndërmarrje.

VIII. ORGANET E NDERMARJES

Neni 18

Organet e ndërmarrjes komunale janë:

- Këshilli drejtues;
- Këshilli për kontrolle të punës material-financiare dhe
- Drejtori

1. Këshilli Drejtues

Neni 19

Organ udhëheqës i Ndërmarrjes është Këshilli Drejtues.

Anëtarët e Këshillit Drejtues i emëron gjegjësisht shkarkon themeluesi i ndërmarrjes.

Për anëtarë të Këshillit Drejtues emërohen përfaqësues nga radhët e personave të njohur dhe afirmuar në sferën komunale, duke pasur parasysh përfaqësimin adekuat të përfaqësuesve të të gjitha nacionaliteteve.

Kohëzgjatja e mandatit të antarëve i Këshillit Drejtues është katër vjet.

Neni 20

Antari i K.D. nuk mund të ketë interes të vetin, të personit të tret ose në çfardo qoftë baze interes në ndërmarrje apo ndërmarrje tregtare e cila është në mardhënie afariste me Ndërmarrjen që mund të ndikoj në pamvarsinë e vendosjes së N.P.K.

Çdo antar i Këshillit Drejtues dhe Drejtori janë të obliguar t'ia bejnë me dije themeluesit egzistimit e interesit të till, nga ana e njërit ose më tepër anëtarëve.

Neni 21

Në mbledhjen e parë Këshilli Drejtues zgjedh Kryetarin, dhe Zevendesin e Kryetarit nga radhët e veta.

Kryetari dhe zevendes Kryetari zgjedhen me mandate prej kater viteve.

Kryetari i K. D e thëret mbledhjen e K. D dhe udhëheq me mbledhjen, kujdeset për punën e K. D dhe kryen detyra tjera për implementimin e akteve të K. D dhe kryen punë tjera të caktuara me rregulloren e punës të K. D

Në mungesë të Kryetarit, zevendes Kryetari e konvokon mbledhjen e Këshillit Drejtues.

Mbledhjet e Këshillit Drejtues caktohen (konvokohen) sipas nevojës.

Neni 22

Për kryetar të Këshillit Drejtues, zevendes ose antar nuk mund të emërohet personi të cilit me aktvendim të plotfuqishëm i është caktuar burgim për shkak të vjedhjes, mashtrimi, keqpërdorimi të besimit, falsifikimit, dhenjes së deklaratave të rejlshme si i betuar, personi i cili ka qen antar i Këshillit Drejtues ose organit tjetër drejtues si dhe bartës i funksionit udhëheqës në sipërmarrje e cila është luikuiduar me falementim

Neni 23

Kryetari i Këshillit Drejtues i kryen posacerisht keto detyra:

1. E konvokon dhe udheheq me mbledhjen e Keshillit Drejtues.
2. Kujdeset qe per punet per te cilat vendos Keshilli Drejtues te kryhen ne menyre te perpikte dhe per to te aprovon Vendime te drejta.
3. Nenshkruan vendimet e Keshillit Drejtues dhe kujdeset per realizimin e tyre.
4. Ben pune te tjera te percaktuara me Ligj, Statutin dhe aktet e ndermarjes

Neni 24

Këshilli drejtues i ndërmarejes Komunale ka ingerenca të ndërmer masa që janë të nevojshme dhe të dobishme për punën e Ndërmarjes Komunale, në pajtim me Ligjin dhe atë:

- Sjell Statutin dhe aktet tjera të Ndërmarjes Komunale;
- Aprovon planin për punë dhe porogramën për zhvillim të ndërmarjes;
- Përcakton politikën afariste;
- Aprovon regulloren për punë të Këshillit Drejtues;
- Aprovon llogarinë vjetore dhe raportin për punën e Ndërmarjes;
- Vendos për pordorimin e mjeteve të realizuara me punë të Ndërmarjes dhe mbulimin e humbjeve
- Bjen vendime për investim;
- I përcakton cmimet e prodhimeve dhe shërbimeve për shërbimet që i kryen;
- Bjen vendime për organizimn e brendshëm të Ndërmarjes dhe regullore për sistematizimin e vendeve të punës në Ndërmarje;
- Formon komision të përhershme dhe të përkohshme;
- Aprovon kontratën kolektive;
- Vendos për udhëtime zyrtare të Drejtorit jashtë vendit;
- Bjen vendime dhe masa për avansimin e ambientit jetsor;
- Kujdeset për informim të punëtorëve
- Vendos për ndryshime statutare në pajtim me ligjin;
- Vendos për ndërprerjen të mardhënjes së punës në shkallë të pare në pajtim me Ligjin për mardhënie për punë;
- Vendos për huazimet e Ndermarjes Publike
- Bën punë të tjera të përcaktuar me Ligj, vendimet e themeluesit, këtij Statuti dhe aktet e përgjithshme të Ndërmarjes.

Nga aktet e nenit 24 paragrafi 1, alineja 1, 2, 5, 6, 7, 8, 15 dhe 17 pëlqim jep Themeluesi.

Neni 25

K. D plotësisht punon dhe bjen vendime në qoftëse në mledhjen e K. D jan prezent më shum se gjisme e anëtarëve.

Vendimet e Këshillit Drejtues llogaritë si të aprovuara nëse për ato kanë votuar më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit Drejtues.

Çdo anëtar i këshillit drejtues gjatë votimit ka një vote.

Puna dhe forma e vendimarrjes së K. D më detajisht rregullohet me rregulloren për punë të K. D

Neni 26

Këshilli Drejtues vendimet i bjen me votim publik të anëtarëve.

~~Anëtarët e Këshillit Drejtues mundën me shumicë të votave prej numrit të përgjithshëm të anëtarëve që vendosin disa prej vendimeve që ti aprovojnë me votime të fshehtë~~

Neni 27

Ndërmarrja nuk mundet që kryetarit të Këshillit Drejtues apo anëtarit të K. D, kryetarit të Këshillit për mbikqirje finansiare apo anëtarit të këshillit për mbikqirje finansiare apo Drejtorit të Ndërmarrjes të ju jap kredi apo garancione për kredi që I kanë nënshkruajtur me persona të tretë.

Neni 28

Mënyra e punës të Këshillit Drejtues përcaktohet me rregullore të posaçme që e aprovon Këshilli Drejtues.

Neni 29

~~Anëtarët e K. M në kryerjen e përgjegjësiave të tyre me të cilat i shkaktohet dëm ndërmarrjes përgjigjen pakufi dhe bashkërisht për dëmet e shkaktuara nga ekzekutimi i vendimeve të tilla~~

Përgjegjësia e K. D përcaktohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Tregtare që kanë të bëjnë me organet qeverisëse.

2. Këshilli për kontroll të punës material finansiare

Puna e K. Mbikqyrës

Neni 30

Organ për kontroll të punës material - finansiare të Ndërmarrjes Publike Komunale është Këshilli për kontroll të punës materialo – finansiare në tekstin e mëtejshëm këshilli mbikqyrës,

Këshilli mbikqyrës është I përzier prej pesë anëtarëve që i emëron gjegjësisht shkarkon Themeluesi

Neni 31



Per anetar te Keshillit per kontroll, mund te emnohen persona te cilet posedojne dituri dhe pervoja posacerisht nga lemija e kontabilitetit financiar.

Anëtarët e keshillit drejtues emërohen me mandatë 4 vjeçar.

Neni 32

Kshilli Mbikqirës punën e vetë e kryen në bazë të kompetencave ligjore dhe statutare

Keshilli mbikqirës patjetër e ka që të mlihdet së paku 4 (katër) here në vit.

Për rezultatet nga kontrolla e bërë, Kshilli Mbikqirës e informon Këshillin Drejtues dhe themeluesin

Keshilli per kontrole e ka te obligushme kontrollimin e llogarive vjetore dhe raporteve per punen e Ndermarjes Komunale Publike dhe pas kontrolles jep mendimin e vet Keshilli drejtues.

Keshilli Drejtues nuk mund te aprovoj llogarite vjetore dhe raportin per pune, nese paraprakisht nuk merr mendim pozitiv prej Keshillit per kontroll.

Neni 33

Anëtarët e K. M në kryerjen e përgjegjësi të tyre me të cilat i shkaktohet dëm ndërmarrjes përgjigjen pakufi dhe bashkërisht për dëmet e shkaktuara nga ekzekutimi i vendimeve të tilla

Përgjegjësia e K. D përcaktohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Tregtare që kanë të bëjnë me organet qeverisëse.

3. Drejtori

Neni 34

Organ udhëheqës Me punen e Ndermarjes Komunale Publike është drejtori

Drejtori i ndërmarrjes e emëron në bazë të konkursit publik gjegjësisht e shkarkon Kryetari I Komunës së Sarajit.

Drejtori emenohet me mandate prej kater viteve.

Neni 35

Per Drejtor te ndermarjes Komunale Publike mund te emerohet personi I cili pervec kushteve te pergjithshme te parashikuara me Ligj duhet t'i permbush edhe keto kushte te posaçme:

1. Te kete te kryer kualifikimin e larte professional (KLP), shkalla VII e arsimit.

2. Te kete pervoje pune

Neni 36

Drejtori i Ndermarjes Publike Komunale:

- Siguron aplikimin e vendimeve te Keshillit Drejtues:
- Propozon dhe mer pjesë në realizimin e politikës afariste programën për punë dhe zhvillim të ndermarjes
- Sjell akte dhe jepë urdhëresa për realizim të punëve nga fusha e vetë, për realizimin e programës për punë dhe zhvillim dhe jepë për ndrishime dhe plotsime të njëjtave.
- Mer pjese ne percaktimin e kriteriumeve per shfrytezimin dhe disponimin me mjetet te realizuara me punen e ndermarjes dhe perdorimin e tyre:
- ben harmonizimin e politikës afariste te ndermarjes:
- ben perfaqesimin dhe paraqitjen e ndermarjes, nënshkruan marrëveshje dhe mer punë tjera juridike në bazë të ligjit.
- Propozon sjelljen e akteve në fushën e K. D
- Propozon regulloren për organizim të brendshëm dhe regullore për sistematizim të vendeve të punës në Ndërmarrje
- I emëron dhe shkarkon punëtorët në vende udhëheqëse të Ndërmarrjes
- Dorëzon raporte deri te K. D dhe Themeluesi për rezultatet e punës së Ndërmarrjes periodikisht dhe llogari vjetore
- E ndjek dhe analizon realizimin e planeve dhe obligimet e mara dhe mer masa për tejkalimin e tyre.
- Sjell vendime për orarin e punës për punëtorët dhe pushim gjatë orarit të punës
- Sjell regulla për punë dhe disiplin
- Aprovon vendime për shpalljen e konkursit për punime të reja të punetoreve, shpërndarje dhe ndërprerje të marrëdhënieve të punës në bazë të ligjit
- ben selektimin e kandidateve te paraqitur me konkursin e shpallur;
- formon komisione te perkohshme profesionale:
- urdheron dhe nenshkruan flete urdherese per kryerjen e puneve te caktuara ne ndermarje:
- mer iniciative dhe nxit kreativitetin ne kryerjen e puneve te Ndermarjes Komunale Publike:
- mër masa për mbrojtjen e punëtorëve dhe ambientit jetësor
- kryen pune te tjera te parashikuara me Ligj dhe me Statut dhe akte tjera të Ndërmarrjes
- mer pjese ne punen e Keshillit Drejtues pa te drejte vote dhe jep mendime dhe propozime ne lidhje me pyetje konkrete:
- per rezultatet e punes te ndermarjes jep raporte 3-mujorshe 6- mujorshe dhe 1-vjecar.

Neni 37

Drejtori i NKP eshte pergjegjes per ecurite e ndermarjes dhe ligjshmerine e puneve të NKP para kryetarit të Komunës së Sarajit

Përgjegjësia e Drejtorit përcaktohet në bazë të dispozitave të ligjit për Ndërmarrje Tregtare që kanë të bëjnë me organet egzekutive.

Neni 38

Drejtori i Ndërmarrjes mundë të shkarkohet edhe para se ti kaloj mandate për të cilën është i emërum:

- më kërkesë personale
- nuk e arinë programën për punë të ndërmarrjes
- me fajin e tij është bërë dëm Ndërmarrjes
- nuk punon në bazë të ligjit dhe statutit
- tjera raste të caktuara me ligj

Neni 39

Në rastë të ndërprejes së mandatit të Drektorit, pa mare parasish se për çfar, deri në emërim të drejtorit të ri, Kryetari i Komunës së Sarajit emëron Ushtrues Detyre në detyrën Drejtor të Ndërmarrjes

Neni 40

Drejtori mund që të çaktoj të punësuar në Ndërmarrje që ta zëvendësoj në mungesë të tij dhe e udhëheq punën rjedhëse të Ndërmarrjes

Personi I punësuar e zëvendëson drejtorin e Ndërmarrjes në mungesë të tij apo pengesës që ta kryej funksionin e tij, me të drejta dhe obligime që do I përcaktoj drejtori , në bazë të ligjit dhe këtij statuti.

Dispozitat e nenit 22 të këtij statuti aplikohen edhe për drejtorin dhe anëtarët e këshillit mbikqirës të Ndërmarrjes

IX. PUNONJËSIT MENAXHERIAL

Neni 41

Punonjësit menaxherial janë punëtorë me kompetenca dhe përgjegjësi të veçanta

Punonjësit menaxherial I emëron dhe shkarkon drejtori I Ndërmarrjes

Neni 42

Punonjësit menaxherial e udhëheqin dhe organizojnë punën në kuadër të kompetencave të deleguara dhe i kryejnë urdhërat, urdhëzimet dhe detyrat e drejtorit të Ndërmarrjes

Punonjësit menaxherial janë përgjegjës për rezultatet dhe ligjëshmërin e punës në njësitë organizative me të cilat udhëheqin

Kushtet për zgjedhje, kompetencat dhe përgjegjësitë të punonjësve menaxherial, si dhe përshtetimi i obligimeve përcaktohen me aktin për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Ndërmarrje.

X. TË PUNËSUARIT NË NDËRMARRJE

Neni 43

Të drejtat e të punësuarve në Ndërmarrje realizohen në bazë të ligjit, kontratave kolektive dhe akteve të përgjithshme të Ndërmarrjes.

Neni 44

Gjatë punësimit në ndërmarrje aplikohet parimi i përfaqësimit të barabartë të qytetarëve që i përkasin të gjitha komuniteteve pa cenuar kriteret e profesionalizmit dhe kompetencës.

XI. AKTET E PËRGJITHSHME TË NDËRMARRJES

Neni 45

Aktet e përgjithshme të Ndërmarrjes janë:

1. Statuti i Ndërmarrjes;
2. Regullore për organizim të brendshëm të Ndërmarrjes;
3. Regullore për sistematizim të vendeve të punës në Ndërmarrje;
4. akte tjerë në pajtueshmëri me Ligjin.

Neni 46

Ky statut është akti bazë i Ndërmarrjes.

Aktet tjera duhet që të jenë në përputhshmëri me këtë Statut.

Dispozitat e akteve të tjera që janë në kundërshtim me këtë statut nuk mund të zbatohen.

Neni 47

Procedura për sjelljen, ndryshime dhe plotësime të akteve të përgjithshme meren me iniciativ të drejtorit, Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikqyrës

Drejtori, gjegjësisht K. D e vlerësojnë arsyeshmërinë e ngritjes së iniciativës së paragrafit i këtij neni.

Neni 48

Aktet e përgjithshme të Ndërmarrjes shpallen në tablon e shpalljes dhe hynë në fuqi në dytën e shpalljes, nëqoftë se duhet pëlqim nga themeluesi, akti i përgjithshëm shpallet pas fitimit të pëlqimit.

XII. OPERIMI I NDËRMARRJES

I. Prona dhe asetet e Ndërmarrjes.

Neni 49

Prona e Ndërmarrjes përbëhet nga të gjitha objektet , burimet, paratë dhe të drejtat. Ndërmarrja punon me aq llogari bankare sa është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të sajë.

Neni 50

Fondet për punën e ndërmarrjes sigurohen nga :

- Të ardhurat që i realizon Ndërmarrja;
- Buxheti i Komunës së Sarajit ;
- Kreditë dhe fondet tjera në pajtim me ligjin .

Neni 51

Kompania është i detyruar të dorëzojë raporte tremujore deri te themeluesin e cila përmban treguesit e performancës financiare .

II Programi dhe zhvillimin e ndërmarrjeve .

Neni 52

Për performanca pozitive dhe zhvillimin të kompanisë , apo për të siguruar një aktivitet të përhershëm dhe të vazhdueshëm , cilësinë e shërbimit dhe rritjen e suksesit në K. D miraton Programin e Punës dhe zhvillimi në propozim të Drejtorit të Ndërmarrjes.

Themeluesi jep pëlqimin për Programite punës dhe zhvillimit .

Për realizimin e programës së punës dhe zhvillimit të Ndërmarrjes përgjegjëse është drejtori i Ndërmarrjes.

XIII. PUNA PUBLIKE

Neni 53

Ndërmarrja e zhvillon dhe realizon sistemin e informimit të shfritëzuesve të shërbimit si një parakusht i rëndësishëm për funksionin e saj në Komunën e Sarajit.

Aktet që janë të rëndësishme për shfritëzuesit e shërbimeve të Ndërmarrjes shpallen në "Gazetën Zyrtare të Komunës së Sarajit " .

Ndërmarrja është e obligueshme për shkak të punës së saj , dhe programet e zhvillimit të informojë rregullisht publikun nëpërmjet mediave dhe mënyra tjetër të përshtatshme .

Neni 54

Ndërmarrja është e obligueshme rregullisht, menjëherë, në mënyrë të plotë dhe me vërtetësi të informoj punëtorët për të gjitha çështjet që janë të rëndësishme për funksionimin dhe zhvillimin e Ndërmarrjes, dhe për të realizuar të drejtat e tyre .

Punonjësit e Ndërmarrjes informohen përmes gazetave , gazetave të brendshme , buletini dhe forma të tjera të medias .

XIV. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 55

Aktet e përgjithshme të ndërmarrjes të përcaktuar me këtë Statut , do të harmonizohen dhe të miratohen brenda tre (3) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Statutit .

Deri në harmonizim , pra miratimin e akteve të përgjithshme të paragrafit të mësipërm do të zbatohen aktet e përgjithshme që janë në fuqi, nëse nuk janë në kundërshtim me këtë Statut .

Neni 56

Pas hyrjes në fuqi të këtij statuti, do të shfuqizohet Statuti i deritanishëm .

Neni 57

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e tetë, pas marrjes më parë pëlqimit të Këshillit të Komunës së Sarajit

NPK SARAJ- SARAJ

KSHILLI DREJTUES

KRYETAR